



Seancës Plenare

[Large blue handwritten signature]



KUVENDI
NR 4855 DATE 23.12.24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2024

Lënda : Depozitim projektligji.

Drejtuar : Znj.Elisa Spiropali

Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Enderuar Znj.Kryetare,

Bazuar në nenin 81, pika 1 , të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 68 të Rregullores së Kuvendit, ju paraqes projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Duke ju falënderuar,

DEPUTETI PROPOZUES

NASIP NACO

[Large blue handwritten signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. ____ /2024

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.81/2020, “PËR TË
DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË
PARABURGOSURVE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

VENDOSI:

Në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 16, pas pikës 4, shtohet pika 4/1 si më poshtë:

“4.1. Përjashtimi nga parashikimet e mësipërme Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve vendos kalimin e të dënuarve nga një institucion i sigurisë së lartë në një institucion të sigurisë së zakonshme me kërkësë të drejtorit të institucionit, të dënuarit ose të përfaqësuesit të tij ligjor ku ekzekutohet vendimi ndaj të dënuarit, në rast se i dënuari ka kryer jo më pak se 2/3 e dënitit.”

Neni 2

Në nenin 18, pika 1, ndryshohet si më poshtë :

1.Institucionet e sigurisë së zakonshme janë institucionet ku ekzekutohen dënimet ndaj të gjithë të dënuarve, për vepra penale, dënim i të cilave i kalon pesë vjet burgim me përjashtim të atyre që vendosen në institucionet e sigurisë së lartë.

Neni 3

Në nenin 19, pas pikës 1, shtohet pika 1/1 si më poshtë :

“1.1 Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së ulët janë institucionet në të cilat, të dënuarit kryejnë dënimin me mbikëqyrje me perimeter sigurie minimal.

Neni 4

Në nenin 20 pika 1 të bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

1.Pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1.Institucioni i hapur është institucioni ose seksioni ku ekzekutohen dënimet ndaj:
a) të dënuarit me burgim, të cilit i ka mbetur më pak se 2 vjet e 6 muaj burgim për të vuajtur, me kusht që i dënuari të ketë siguruar një kontratë të rregullt pune në institucionin e hapur, kur raporti i komisionit të vlerësimit të rrezikshmërisë së të dënuarve vlerëson se nuk përbën rrezik për sigurinë e institucionit apo të shoqërisë;
b) të dënuarit me gjysmëliri. “

2.Pas pikës 1, shtohen pikat 1/1, 1/2, 1.3 dhe 1.4 si më poshtë :

“1.1 Institucioni i hapur është institucioni në të cilin, i dënuari kryen dënimin me mbikëqyrje me perimeter sigurie minimal dhe nuk mbyllt në qelitë e burgut.

1.2 Për marrjen e vendimit për transferim, Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve mban në konsideratë nëse transferimi lehtëson riintegrin e të dënuarit, ndihmon në mbajtjen e lidhjeve familjare, sociale dhe ekonomike, përmes aksesit në punësim.

1.3 Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve vendos kalimin e të dënuarve nga një institucion i sigurisë së ulët në një institucion të hapur me kërkesë të drejtorit të institucionit ku ekzekutohet vendimi ndaj të dënuarit ose të

përfaqësuesit të tij ligjor, në rast se plotësohen kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

1.4 Kontrata e rregullt e punës në institucionin e hapur është një marrëdhënie juridike që formalizohet me kontratë midis të dënuarit dhe institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, institacioneve të tjera shtetërore ose bizneseve private. Rregullat dhe procedurat mbi kontratën e punës në institucionin e hapur miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

ELISA SPIROPALI

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR

“DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.81/2020, “PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË PARABURGOSURVE”

Analiza e legjislacionit ekzistues dhe propozimet për ndryshim të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”

Në kontekstin e Ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", propozimi për ndryshimin e metodologjisë së klasifikimit të sigurisë së të dënuarve synon të rrisë efikasitetin e procesit, duke e bërë atë më të shpejtë dhe më pak të ngarkuar për gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm. Ky ndryshim është i rëndësishëm për të adresuar sfidat e menaxhimit të të dënuarve, mbipopullimin dhe përmirësuar efikasitetin e sistemit të burgjeve, pa cënuar të drejtat e palëve.

Në këtë kontekst sugjerohet të shtohet pas pikës 4 të nenit 16 të ligjit 81/2020 pika 4/1 me këtë përbajtje;

“4.1. Përjashtimisht nga parashikimet e mësipërme Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve vendos kalimin e të dënuarve nga një institucion i sigurisë së lartë në një institucion të sigurisë së zakonshme me kërkesë të drejtorit të institucionit, të dënuarit ose të përfaqësuesit ku ekzekutohet vendimi ndaj të dënuarit, në rast se i dënuari ka kryer jo më pak se 2/3 e dënimit..”.

Në analizë të dispozitave ekzistuese Neni 19, pika 2 parashikon procedurën për kalimin e të dënuarve nga një institucion i sigurisë së zakonshme në një të sigurisë së ulët pas kalimit të afatit 2/3 e dënimit, e konkretisht "...Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve vendos kalimin e të dënuarve nga një institucion i sigurisë së zakonshme në një institucion të sigurisë së ulët me kërkesë të drejtorit të institucionit ku ekzekutohet vendimi ndaj të dënuarit ose të përfaqësuesit të tij ligor, në rast se i dënuari ka kryer jo më pak se 2/3 e dënimit..."

Vërehet se nuk ka një përcaktim të tillë për kalimin nga një institucion i sigurisë së lartë në një të sigurisë së zakonshme pas një afati të caktuar kohor ndryshe nga parashikimet që ligjvënësi ka parashikuar për kalimin e personave nga siguria e zakonshme në siguri të ulët. Kjo shtesë e propozuar ka për qëllim të rregullojë këtë moment pas kalimit të afatit 2/3 e dënit duke ofruar një mekanizëm të qartë dhe të strukturuar për këtë lloj kalimi, duke siguruar kështu një trajtim më të drejtë dhe të barabartë të të dënuarve dhe përmirësimin e menaxhimit të sigurisë brenda sistemit të burgjeve.

Argumentimi juridik

Shtimi i kësaj pike siguron një kohërencë më të madhe dhe plotëson një vakum ligjor. Përparësi jepet sigurisë dhe rregullave të drejta, duke lejuar që të dënuarit që kanë demonstruar sjellje të mirë dhe kanë përbushur kushtet e tjera, të kalojnë në një institucion me një nivel më të ulët të sigurisë, kjo ndihmon në procesin e tyre të rehabilitimit dhe riintegrimin në shoqëri.

Rregullimi i këtij momenti në ligj do të ul numrin e kërkesave për ndryshim e klasifikimit të sigurisë në gjykata, pa cënuar të drejtën e palëve për të ushtruar të drejtën e ankimit pranë gjykatës kompetente.

Me anë të këtij ndryshimi, ligji trajton në mënyrë të barabartë të dënuarit nga të gjitha nivelet e sigurisë, duke u ofruar atyre mundësinë e rishikimit të statusit të tyre të sigurisë bazuar në sjelljen dhe përmirësimin e tyre gjatë periudhës së dënit, në përputhje me parimet e drejtësisë restauruse.

Duke lejuar kalimin nga një institucion i sigurisë së lartë në një të sigurisë së zakonshme, ky amendim ndihmon në menaxhimin e më të mirë të dënuarve në burgje, duke reduktuar ngarkesën në institucionet e sigurisë së lartë dhe duke shpërndarë më efikasitet burimet njerëzore dhe logjistike.

Gjithashtu ndihmon në forcimin e politikave që promovojnë rehabilitimin e të dënuarve, duke i inkurajuar ata të punojnë për përmirësimin e e indikatorëvë rehabilitues, përfitimin e kalimit në një mjedis me nivel sigurie më të ulët si dhe përfitim nga ulja e dënit referuar parashikimeve të nenit 75 të ligjit, ku i dënuari kur ka një sjellje të mire, duke e treguar me pjesëmarrje aktive dhe pozitive në veprimtaritë rehabilituese dhe riintegruese gjatë kryerjes së dënit, bazuar në raportin e vlerësimit, që përgatitet nga institucioni, me kalimin nga IEVP të sigurisë të larte ku ulja e dënit bëhet deri 45 ditë në vit, në IEVP të sigurisë së zakonshme, të përfitojë ulje dënimisë deri 90 ditë në çdo vit të kryerjes së dënit në IEVP.

Gjithashtu do të rrisë motivimin e të dënuarve për të ndryshuar dhe në uljen e recidivizmit.

Ndryshimi i nenit 18 pika 1:

Neni 18 pika 1 parashikon; “...*I. Institucionet e sigurisë së zakonshme janë institucionet ku ekzekutohen dënimet ndaj të gjithë të dënuarve, me përjashtim të atyre që vendosen në institucionet e sigurisë së lartë, në institucionet e sigurisë së ulët dhe në institucionet e hapura...*”

Në nenin 18, Pika 1, **ndryshohet** në : “...*I. Institucionet e sigurisë së zakonshme janë institucionet ku ekzekutohen dënimet ndaj të gjithë të dënuarve, për vepra penale, dënim i të cilave i kalon pesë vjet burgim me përjashtim të atyre që vendosen në institucionet e sigurisë së lartë....*”

Argumentimi juridik për ndryshimin e propozuar në nenin 18, pika 1, i referohet nevojës për unifikim, vijueshmëri dhe qëndrueshmëri në interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit në përputhje me dispozitat e tjera të ligjit. Ky ndryshim është i rëndësishëm për të siguruar që klasifikimi i institucioneve penale dhe caktimi i të dënuarve në këto institucione të jetë i qartë dhe i bazuar mbi kriteret ligjore.

Nga analizimi i dispozitave ekzistuese në nenin 19 pika 1 e ligjit 81/2020 parashikohet “...*Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së ulët janë institucionet ku ekzekutohet dëimi për të dënuarit për kundërvajtje penale, për vepra penale nga pakujdesia dhe për vepra të tjera penale, dënim i të cilave nuk i kalon pesë vjet burgim...*”. ndërsa nen 18 pika 1 e ligjit 81/2020 parashikon “...*Institucionet e sigurisë së zakonshme janë institucionet ku ekzekutohen dënimet ndaj të gjithë të dënuarve, me përjashtim të atyre që vendosen në institucionet e sigurisë së lartë, në institucionet e sigurisë së ulët dhe në institucionet e hapura...*”.

Neni 19 pika 1 përcakton qartë se institucionet e sigurisë së ulët janë për të dënuarit për kundërvajtje penale, vepra nga pakujdesia dhe vepra të tjera penale që sjellin dënim deri në pesë vjet burgim. Kjo krijon një kategorizim të qartë të të dënuarve bazuar në rëndësinë relative të veprës dhe dënimin e caktuar. Propozimi për të ndryshuar nenin 18 pika 1 krijon harmonizim sa i përket dënitit mbi pesë vjet burgim në institucionet e sigurisë së zakonshme duke bërë një ndarje të qartë midis institucioneve të sigurisë së zakonshme dhe sigurisë së ulët, ku sugjerohet ndryshimi për nenin 18 pika 1 “...*Institucionet e sigurisë së zakonshme janë institucionet ku ekzekutohen dënimet ndaj të gjithë të dënuarve, për vepra penale, dënim i të cilave i kalon pesë vjet burgim me përjashtim të atyre që vendosen në institucionet e sigurisë së lartë...*”

Amendimet e propozuara synojnë të:

- Vendosjen e kritereve të qarta për klasifikimin e të dënuarve në institucionë të ndryshme në përputhje me nivelin e sigurisë, amendimet e propozuara synojnë të përmirësojnë efikasitetin në menaxhimin dhe funksionimin e institacioneve të ekzekutimit të vendimeve penale. Kjo ndihmon në mirë organizimin e burimeve njerzore, logistike dhe në menaxhimin më të mirë të sigurisë.
- Duke krijuar ndarje të qarta bazuar në dënimin dhe natyrën e veprave penale, ndryshimet ligjore sigurojnë një mjedis më të kontrolluar dhe të sigurtë, ku çdo grup i të dënuarve trajtohet në mënyrë të përshtatshme dhe proporcionale me rrezikshmërinë që paraqesin.
- Me ndarjen e qartë të të dënuarve në institucionë të sigurisë së zakonshme për dënimet mbi pesë vjet, krijohen kushte më të përshtatshme për trajtimin dhe rehabilitimin e atyre që janë me një rrezik relativisht më të ulët se ata në institucionet e sigurisë së lartë. Ky ndryshim ndihmon në përmirësimin e programeve të rehabilitimit dhe në përgatitjen e të dënuarve për rikthimin në shoqëri.
- Duke qenë se, kriteret për vendosjen në institucionë të ndryshme bëhen më të qarta dhe bazohen më shumë në natyrën objektive të veprave dhe dënimive, ligji rrit gjithashtu perceptimin e drejtësisë dhe barazisë në trajimin e të dënuarve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të ruajtur legjitimitetin e sistemit të drejtësisë penale dhe për të forcuar besimin e publikut.
- Me ndarjen e të dënuarve në institucionë të sigurisë së zakonshme bazuar në kriteret e reja, politikat dhe programet e rehabilitimit zhvillohen dhe të zbatohen në mënyrë efektive, duke pasur parasysh nevojat specifike dhe rrezikshmërinë e këtij grupi të të dënuarve.

Amendim i nenit 19, ku pas pikës 1 shtohet pika 1/1 si më poshtë:

“1.1 Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së ulët janë institucionet në të cilat, të dënuarit kryejnë dënimin me mbikëqyrje me perimeter sigurie minimal.

Argumentimi juridik:

Duke përcaktuar mbikëqyrjen me perimetër sigurie minimal, apo dhe në rastin e institacioneve të hapura pa u mbyllur në qelitë e burgut ne do të mundësojmë

forcimin e perimetrit të sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë duke rritur numrin e policëve që shërbejnë në këto IEVP, pasi në institucionet e sigurisë së ulët dhe ato hapura nevojitet një numër më i vogël policësh për të monitoruar e mbikëqyrur të dënuarit e transferuar në këto institucione.

Amendim i nenit 20 pika 1.

Propozimi për amendimin e nenit 20, pika 1 e Ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" synon të zgjerojë kushtet për kalimin në një institucion të hapur dhe të përmirësojë procesin e vendimmarrjes për këto kalime, bazuar në një vlerësim më gjithëpërfshirës të rrezikshmërisë dhe rrethanave sociale të të dënuarit. Ky ndryshim është i rëndësishëm për të lehtësuar riintegrimin e të dënuarve në shoqëri në një mënyrë më efikase dhe humane.

Të amendohet nen 20 pika 1 e ligjit 81/2020, i cili parashikon :

1. Institucioni i hapur është institucioni ose seksioni ku ekzekutohen dënimet ndaj:
 - a) të dënuarit me burgim, të cilil i ka mbetur më pak se gjashtë muaj burgim për të vuajtur dhe kur raporti i komisionit të vlerësimit të rrezikshmërisë së të dënuarve vlerëson se nuk përbën rrezik për sigurinë e institucionit apo të shoqërisë;
 - b) të dënuarit me gjysmëliri.

Në nenin 20 pika 1 të bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

1.Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1.Institucioni i hapur është institucioni ose seksioni ku ekzekutohen dënimet ndaj:

- a) të dënuarit me burgim, të cilil i ka mbetur më pak se 2 vjet e 6 muaj burgim për të vuajtur, me kusht që i dënuari të ketë siguruar një kontratë të rregullt pune në institucionin e hapur, kur raporti i komisionit të vlerësimit të rrezikshmërisë së të dënuarve vlerëson se nuk përbën rrezik për sigurinë e institucionit apo të shoqërisë;
- b) të dënuarit me gjysmëliri. "

Pas pikës 1, shtohen pika 1/1, 1/2, 1.3 dhe 1.4 si më poshtë :

"1.1 Institucioni i hapur është institucioni në të cilin, i dënuari kryen dënimin me mbikëqyrje me perimeter sigurie minimal dhe nuk mbyllët në qelitë e burgut.

1.2 Për marrjen e vendimit për transferim, Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve mban në konsideratë nëse transferimi lehtëson riintegrimin e të

dënuarit, ndihmon në mbajtjen e lidhjeve familjare, sociale dhe ekonomike, përmes aksesit në punësim.

1.3 Komisioni i Vlerësimit të Rezikshmërisë së të Dënuarve vendos kalimin e të dënuarve nga një institucion i sigurisë së ulët në një institucion të hapur me kërkesë të drejtorit të institucionit ku ekzekutohet vendimi ndaj të dënuarit ose të përfaqësuesit të tij ligjor, në rast se plotësohen kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni..

1.4 Kontrata e rregullt e punës në institucionin e hapur është një marrëdhënie juridike që formalizohet me kontratë midis të dënuarit dhe institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, institucioneve të tjera shtetërore ose bizneseve private. Rregullat dhe procedurat mbi kontratën e punës në institucionin e hapur miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave”.

Argumentimi juridik:

- Zgjerimi i kushtit për të përfshirë të dënuarit që u kanë mbetur deri në 2 vjet e 6 muaj burgim mundëson një periudhë më të gjatë dhe më efektive për përgatitjen e tyre për rikthimin në shoqëri, veçanërisht nëpërmjet punësimit të rregullt, i cili është një faktor kyç për suksesin e riintegrimi.
- Duke lejuar kalim më të shpejtë në institucione të hapura për ata që përbëjnë rrezik të ulët, ky ndryshim mund të ndihmojë në reduktimin e ngarkesës dhe përmirësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe logistike në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.
- Përcakton rolin dhe përgjegjësitë e Komisionit të Vlerësimit të Rezikshmërisë në procesin e vendimmarrjes, rrit transparencën dhe përgjegjësinë, duke siguruar që vendimet të jenë të bazuar mbi vlerësimet objektive dhe të gjithanshme të riskut dhe rrethanave të të dënuarit.
- Kalimi në institucione të hapura, ndikon në rolin e lidhjeve familjare dhe sociale të të dënuarve në procesin e rehabilitimit dhe në përmirësimin e suksesit afatgjatë të të dënuarve pas lirimit.
- Amendimi i propozuar ndikon pozitivisht jo vetëm në uljen e kostove për sistemin e burgjeve, por edhe në përmirësimin e mundësive ekonomike dhe shoqërore për të dënuarit dhe familjet e tyre. Sistemi i burgjeve në aspektin e efikasitetit operacional dhe efektivitetit ekonomik ka ulje të shpenzimeve pasi numri i burimeve njerëzore reduktohet, sistemet e sigurisë dhe mbikëqyrjes reduktohen,

infrastruktura për institucionet e hapura është më pak komplekse, për tu ndërtuar dhe mirëmbajtur, ka hapësirë më të aksesueshme, ulje të shpenzimeve të kontrollit, ulje të shpenzimeve shëndetësore, ulje të shpenzimeve rehabilituese etj. Gjithashtu duke lejuar të dënuarit që kanë më pak se dy vjet burgim të punojnë, ndryshimet e propozuara ndihmojnë në integrimin e tyre në tregun e punës që përparrë lirim. Kjo jo vetëm që ofron të ardhura për të dënuarit dhe ndihmon në përmirësimin e stabilitetit financiar të familjeve të tyre, por gjithashtu rrit shanset e tyre për sukses pas lirimit dhe ul rrezikun e recidivizmit.

Si transferimi nga një institucion i sigurisë së lartë në një institucion të sigurisë së zakonshme ashtu edhe vënia në zbatim e burgjeve të regjimit të hapur janë të domosdoshme për të arritur një bashkëjetësë normale, duke rritur përgjegjshmërinë e të dënuarve, për të cilët vlerësohet se dënim i që kanë përbushur deri në çastin e transferimit të tyre, ka përbushur qëllimin edukues të tij.

Kështu, kalimi i të dënuarve që përbushin kriteret ligjore në këto institucione, do të shërbejë si një fazë parapërgatitore për çastin e lirimit të tyre dhe riintegrimin në jetën sociale.

Këto ndryshime propozohen pasi Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale zbatojnë programe të rehabilitimit social, që synojnë modifikimin e sjelljeve kriminale dhe aftësimin me shprehi sociale. Shoqëria civile gjithnjë e më shumë rekomandon që sistemi i burgjeve të hartojë programe konkrete të përgatitjes përiintegrim, që në paraburgim, duke krijuar marrëdhënie institucionale edhe me aktorë të tjera të përfshirë në këtë proces. Kalimi më pas në regjim të hapur, mundëson riintegrimin plotësisht të të dënuarve dhe rehabilitimin e tyre. Një burg i hapur është një institucion penitenciar në të cilin i burgosuri kryen dënimin me mbikëqyrje dhe perimetër sigurie minimal dhe nuk mbyllët në qelitë e burgut. Ndërkohë që vuajnë dënimin e tyre të burgosurit kanë të drejtë të punojnë.

Ideja është që i burgosuri del nga IEVP në mëngjes dhe shkon në vendin e punës së tij. Pas përfundimit të punës, ai menjëherë do të kthehet në institucion dhe të mbetet aty deri në mëngjesin tjetër, në qoftë se ai nuk ka leje ose pushime. Në institucion, të burgosurit mund të marrin pjesë në aktivitete të kohës së lirë, të zhvillojnë aktivitete sportive dhe të përfitojnë në trajtimin e ofruar atje. Shumicën e fundjavave i burgosuri mund t'i kalojë me familjen e tij. Të burgosurve në një burg me regjim të hapur sigurisht që do t'u duhet t'i përbahen në mënyrë strikte rregullave të specifikuara të përcaktuara në rregulloren e brendshme te institucionit. I burgosuri

vendoset me miratimin e tij në një burg me regjim të hapur kur i plotëson kushtet e veçanta për t'u vendosur në një institucion të tillë dhe ky kalim nuk nënkupton që ai t'i shpëtojë dënimit me burgim dhe as të abuzojë me mundësitë e ofruara nga burgjet e hapura për të kryer krimet e tjera.

Burgjet e regjimit të hapur janë të domosdoshme për të arritur një bashkëjetesë normale, duke rritur përgjegjshmérinë e të dënuarve, për të cilët vlerësohet se dëniimi që kanë përbushur deri në çastin e kalimit të tyre në burgjet me regjim të hapur, ka përbushur qëllimin edukues të tij. Qëllimi i regjimit të hapur është nxitja e aftësisë së intergimit social pozitiv të të dënuarve, duke i mbështetur ata dhe duke favorizuar kështu përfshirjen e tyre progresive në komunitet. Ky regjim nxit përgjegjshmérinë, integrimin, forcon lidhjet familjare dhe shoqërore të të dënuarit, sigurisht me bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet që do të ndihmojnë integrimin e tij. Pas këtij hapi, masa konkrete do të duhet të ndërmerren përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duke rritur bashkëpunimin me organizaçionet jo fitimprurëse që kanë në fokus rehabilitimin e të dënuarve si dhe me Shërbimin Kombëtar të Punës, për të mundësuar në vazhdimësi përbushjen e së drejtës së të dënuarve në prag të lirimit për t'u trajtuar me shërbime për t'u mbështetur financiarisht në përpjekjet e tyre për gjetjen e një pune fitimprurëse të përshtatshme për cilësitë individuale dhe aftësitë profesionale. Burgjet me regjim të hapur, në praktikën ndërkombëtare, janë cilësuar si burgje me rezultate të larta sa i përket rehabilitimit të të dënuarit dhe përbushjes së funksionit të dënit.

Gjatë përgatitjes së këtij projektligji është bërë një studim nga Instituti Parlamentar mbi regjin e burgjeve në vendet e BE-së dhe rajon. Vende si Anglia, Gjermania, Holanda, Spanja, Zvicra, Italia, Luksemburgu, Polonia, Mali i zi etj., kanë aplikuar tashmë këtë regjim për një kategori të dënuarish, regjim ky që është vlerësuar tepër pozitiv në drejtim të të drejtave dhe lirive të personave të dënuar.

Në rastin e Anglisë, në kategorinë D, të njohura edhe si “*burgjet e hapura*”, akomodojnë të burgosurit me risk shumë të ulët, të cilët janë gjithashtu në përfundim të vuajtjes së dënit. *Të dënuarit në këto burgje kanë liri lëvizje dhe mund të marrin pjesë në programe pune ose aktivitete komunitare jashtë burgut. Në këto burgje mund të vendosen personat të cilët vuajnë një dënim me burg (me ose pa lirim me kusht) dhe që u kanë mbetur më pak se 3 vjet për t'u liruar.* Në të dyja rastet, personat nuk duhet të janë shtetas/shkelës të huaj ndaj të cilëve është vendosur një urdhër deportimi dhe kanë ushtruar të drejtën e tyre të ankimit. Gjithashtu, personi që vendoset në këtë kategori duhet të vlerësohet nëse: paraqet risk të ulët arratisje (*personat me historik arratisje nuk mund të klasifikohen në burgjet e kategorisë D/*

e hapura); paraqet risk të ulët për të dëmtuar publikun; nuk ka gjasa të vazhdojë kriminalitetin gjatë qëndrimit në paraburgim (në rastet kur nuk është marrë ende vendimi ndaj tij); nuk ka gjasa të abuzojë me sigurinë e ulët ose të prishë rendin e “burgut të hapur”.

Edhe Italia i parashikon 2 regjime burgjesh të hapura: *Regjimi i qelive të hapura dhe Regjimi i gjysmëlirisë*. Regjimi i gjysmëlirisë distancohet nga skema e masave alternative (*nuk është një masë alternative*): institucioni nëpërmjet këtij regjimi synon të lejojë një metodë të ekzekutimit të dënimit me burg që është veçanërisht e favorshme për konsolidimin e evolucionit pozitiv të personalitetit të personit të dënuar, mbi të gjitha nëpërmjet riintegrimit, ndonëse i pjesshëm dhe i kontrolluar, në mjedisin e lirë. Në Itali kompetenca për të urdhëruar pranimin në regjimin e gjysmëlirisë dhe revokimin e tij i takon Gjykatës së Mbikëqyrjes, e cila duhet të vlerësojë përshtatshmërinë, përfshirë efektin e zbatimit të masës, të risocializimit.

Mali i Zi parashikon, **regjimin e hapur të burgjeve (niveli i sigurisë i ulët)** Regjimi i hapur është më pak kufizues, i fokusuar në riintegrinë social dhe përgatitjen e të burgosurve për lirim. Të burgosurit në këtë regjim kanë liri të konsiderueshme lëvizjeje, brenda dhe jashtë institucionit dhe mund të kenë të drejtë për punë të jashtme ose programe arsimore. Ky regjim është më pak kufizues dhe është i krijuar përfshirë shkelësit me rrezik të ulët, të cilët demonstrojnë sjellje të mirë dhe janë afër fundit të dënimit. Ai përfshin shpesh të burgosur të dënuar për krime të vogla dhe për ata që kanë treguar vazhdimisht sjellje të mirë dhe progres drejt rehabilitimit. Të burgosurit në regjimin e hapur mund të kenë mundësi përfshirë të jashtme, programe arsimore, madje edhe leje afatshkurtra përfshirë vizituar familjen në kushte të kontrolluara. Qëllimi është të lehtësohet riintegrimi në shoqëri me kufizime minimale.

Thelbi i këtij sistemi është rehabilitimi social, vetëqeverisja, qasja në mjedisin social, dhe kostojë e ulët. Ky sistem lejon që shoqëria të rifitojë besimin në personin që ka kryer një vepër penale, pjesërisht nga rezultatet që ka treguar në vendet e tjera ky sistem dhe pjesërisht përfshirë shkak të efekteve pozitive që paraqet ky sistem tek i dënuari. Qëllimi përfshirë vendosjen e afatit 3 vjeçar të mbetur nga vuajtja e dënimit, përfshirë aplikimin e burgut me regjim të hapur, përfshirë dënuarit ekzekutimi i dënimit të cilin bëhet në një institucion të sigurisë së ulët dhe afati 1 vjeçar të mbetur nga vuajtja e dënimit, përfshirë dënuarit ekzekutimi i dënimit të cilin bëhet në një institucion të ndryshëm nga ai i sigurisë së ulët, është krijimi i mundësisë përfshirë zëvendësuar konceptin e vjetër të dënimit me rehabilitimin social të autorëve të veprave penale,

duke parandaluar kështu në mënyrë efektive recidivizmin dhe duke i përgatitur të dënuarit për jetën në liri.

Në lidhje me kostot financiare, është e rëndësishme të theksohet se ky projektligj parashikon të sjellë efekte pozitive financiare si në buxhetin e shtetit ashtu edhe në rritjen e eficencës së përdorimit të policisë së burgjeve.

Konkretnisht referuar statistikave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në Republikën e Shqipërisë numri total i të dënuarve dhe paraburgosurve është 5031 ndërsa numri i punonjësve të Policisë është 2891. Pra raporti polic për të dënuar është 1/1, konkretnisht 1 polic për çdo të dënuar.

Nga këta 637 janë të dënuar për vrasje dhe 1543 për vepra penale të tjera. Në institucionet e sigurisë së lartë vuajnë dënimin 496 të dënuar ndërsa në institucionet e sigurisë së zakonshme 1129 të dënuar. Aktualisht kemi 0 të dënuar që vuajnë dënimin në Institucion të sigurisë së ulët apo të transferuar në institucion të hapur. Duke bërë eficent regjin e hapur dhe transferimin e të dënuarve që plotësojnë kriteret në IEVP të sigurisë së ulët apo në ato të hapura do të mundësojmë forcimin e perimetrit të sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë duke rritur numrin e policëve që shërbejnë në këto IEVP, pasi në institucionet e sigurisë së ulët dhe ato hapura nevojitet një numër më i vogël policësh për të monitoruar e mbikëqyrur të dënuarit e transferuar në këto institucione.

Deputeti
Vasil Vasili
~~Vasil Vasili~~